



Fier, më 03.12.2025

BASHKIA FIER

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

(Mbi vendosjen në hapësirat publike të përcaktuara të ekraneve led nga subjektet që ushtrojnë aktivitet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre, ose promovimin e vlerave kulturore, turistike ose arkeologjike të territorit të Bashkisë Fier)

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të kushteve të reja të zhvillimit të qytetit si dhe vendosjes së këtyre strukturave inovative në digitale LED,

Fokusi i thirrjes

Vendosia e ekraneve led në hapësira publike të përcaktuara nga subjektet me qëllim reklamimin e bisneseve, promovimin e vlerave kulturore, turistike ose arkeologjike të territorit të Bashkisë Fier.

Bashkia Fier, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, Ligiin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr. 53, datë 30.04.2024 “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre”, fton të gjithë subjektet e interesuar të cilët ushtrojnë aktivitet reklamues, ose synojnë të reklamojnë biznesin e tyre, ose promovimin e vlerave kulturore, turistike ose arkeologjike të territorit të Bashkisë Fier dhe janë të interesuar ta kryejnë këtë shërbim në hapësirat publike të përcaktuara nga Bashkia Fier pasqyruar në ortofotot :përkatësisht:

- 1.Në veri-lindje të kryqëzimit midis rrugës : “Jani Bakalli” dhe “Ramiz Aranitasi” ;
- 2.Në veri të kryqëzimit midis rrugës “Jakov Xoxa” dhe “ Vangjel Capo” ;
- 3.Pranë urës që lidh kishën me sheshin qëndror , rruga “Jakov Xoxa”;
- 4.Rruga “Ismail Qemali në lindje (tek tregu) do të vërë në dispozicion sipas vendeve të përcaktuara në hartat përkatëse, të paraqesin kërkesën e tyre

- Kërkesa për shprehje interesi është e hapur për të gjithë subjektet e interesuara të cilat duhet të paraqesin kërkesën e tyre brenda datës, 18.12.2025 , ora 16:00 pranë Zyrës së Arkiv-Protokollit Bashkia Fier ose Zyrat One Stop Shop, Bashkia Fier.

1.Kërkësë për shprehje interesi;

2.Dokumentacioni ligjor i regjistrimit të subjektit bazuar në Ligjin Nr.97239723, datë 03.05.2007 Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.